



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3300 Prot.

Vlorë, më 24/10/2023

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e sekuestros & kontabilizimit)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të pesë akteve administrativ – Vendimet për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore si dhe dy Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

- Nr.3110 Prot., datë 05/10/2023, i materializuar për subjektin “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, me banim në Vlorë (Llakatund 034).
- Nr.3264 Prot., datë 19/10/2023, i materializuar për subjektin “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Sado Koshena”, Nr.10), me status në QKB “Aktiv”.
- Nr.3263 Prot., datë 19/10/2023, i materializuar për subjektin “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, me seli në Vlorë (pranë shkollës industriale), me status në QKB “Aktiv”.
- Nr.3262 Prot., datë 19/10/2023, i materializuar për subjektin “RAFAEL SHOES” sh.p.k me NIPT L93102401C, me seli në Fier (Lagjja “Afrim”, Rruga “Afrim i Ri”, z. K 8534, Pasuria nr 15/64), me status në QKB “Aktiv”.

• Nr.3261 Prot., datë 19/10/2023, i materializuar për subjektin “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, me seli në Tiranë (Rruga e Durrërsit, Kthesa e Kamzës), me status në QKB “Aktiv”.

• Nr.90, me Nr.1874/2 Prot., datë 12/10/2023, i materializuar për subjektin “CONSULTING PRODUCTION” sh.p.k me NIPT L66329201T, me seli në Vlorë (Novoselë, rruga nacionale Vlorë – Fier, fshati Novoselë, zona kadastrale nr.1012, nr.pasurie 118/29; Nr. Telefoni të publikuar në Q.K.B 0697714994), me administrator z.Elvis Çeçi.

• Nr.91, me Nr.2976/1 Prot., datë 13/10/2023, i materializuar për subjektin “TOMAIFICIO “MARO” sh.p.k me NIPT L36401201R, me seli në Vlorë (Lagjja “Kushtrimi”, pranë ish përpunim druri, objekt një katësh, Nr.39/102).

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të akteve të lartcituara.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të pesë akteve të lartcituara - gjithsej 17 (Shtatëmbëdhjetë) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Artan Bedinaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3110..... Prot.

Vlorë, më 05/10/2023

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori, subjekti “Aldo Danaj” p.f me ID I60731059V, me banim në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.49, me Nr.1963/1 Prot., datë 14/07/2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 258.636 (Dyqind e pesëdhjete e tetëmijë e gjashtëqind e tridhjet e gjashtë) lekë, për deklaratën doganore IM.4 me numër R 4830, datë 21/04/2021, bazuar në nenin 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, ndaj subjektit debitor “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, me banim në Vlorë (Llakatund 034).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1963/2 Prot., datë 19/07/2023, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresat si vijon : Shkresën nr.2378 Prot., datë 07.08.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Bashkisë Vlorë; me shkresën nr.2380 Prot., datë 07.08.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë, e cila ka konfirmuar shpalljen publike me shkresën e saj Nr.2503 Prot., datë 15.08.2023 me lëndë “Mbi Shpalljen Publike të aktit administrativ me nr....”; shkresën Nr.2608 Prot., datë 25/08/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrative (Vendimet e kontabilizimit)” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer shpalljen publike në websit-in e saj në kolonën “Njoftime” (me shkresën e saj Nr.13909 Prot., datë 28/08/2023). Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me shkresën nr.2923 Prot., datë 21.09.2023 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim lidhur me njoftimin e subjektit debitor”, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit Vlorë, me anë të së cilës i ka kërkuar ndihmesën Tuaj institucionale, me qëllim

njoftimin e vendimit të lartcitur (Nr.49, me Nr.1963/1 Prot., datë 14/07/2023), për subjektin “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V.

Personi fizik natyror “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 49, me Nr.1963/1 Prot., datë 14/07/2023, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.49, me Nr.1963/1 Prot., datë 14/07/2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, apo garantuesit/garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi fizik natyror - “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale **258.636** (Dyqind e pesëdhjete e tetëmijë e gjashtëqind e tridhjet e gjashtë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.49, me Nr.1963/1 Prot., datë 14/07/2023, të Degës së Doganës Vlorë, si dhe kamatë vonesën e lindur.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3264 Prot.

Vlorë, më 19/10/2023

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Penalitetit Doganor që debitori, subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.55, me Nr.2170/2 Prot., datë 07/08/2023, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 50.000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Sado Koshena”, Nr.10), me status në QKB “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, me anë të Shërbimit Postar me shkresën Nr.2170/3 Prot., datë 10/08/2023, me lëndë Njoftim Vendimi. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresat si vijon : Shkresën nr.2606 Prot., datë 25.08.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Bashkisë Vlorë; shkresën Nr.2608 Prot., datë 25/08/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrative (Vendimet e kontabilizimit)” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer shpalljen publike në websit-in e saj në kolonën “Njoftime” (me shkresën e saj Nr.13909 Prot., datë 28/08/2023). Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me shkresën nr.2170/4 Prot., datë 20/09/2023 me lëndë “Rinjoftim vendimi”, si dhe me shkresën Nr.3085 Prot., datë 04/10/2023, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë u ka kërkuar ekzekutimin vullnetar të aktit administrative të lartcitur.

Personi juridik debitor “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 55, me Nr.2170/2 Prot., datë 07/08/2023, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 55, me Nr.2170/2 Prot., datë 07/08/2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 50.000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.55, me Nr.2170/2 Prot., datë 07/08/2023, të Degës së Doganës Vlorë.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3262 Prot.

Vlorë, më 19/10/2023

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori, subjekti “RAFAEL SHOES“ sh.p.k me NIPT L93102401C, me seli në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.65, me Nr.2584/1 Prot., datë 24/08/2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 31.100 (Tridhjetë e njëmijë e njëqind) lekë, për deklaratën doganore IMP. 5 me numër R 8128, datë 21/06/2021, në zbatim të nenit 250/4 të Kodit Doganor, si dhe penalitetin në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, në zbatim të nenit 257/1/b të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, ndaj subjektit debitor “RAFAEL SHOES” sh.p.k me NIPT L93102401C, me seli në Fier (Lagjja “Afrim”, Rruga “Afrim i Ri”, z. K 8534, Pasuria nr 15/64).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “RAFAEL SHOES” sh.p.k me NIPT L93102401C, me anë të Shërbimit Postar me shkresën Nr.2584/2 Prot., datë 28/08/2023, me lëndë Njoftim Vendimi. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresat si vijon : Shkresën nr.2937 Prot., datë 22.09.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Bashkisë Fier, e cila ka konfirmuar kryerjen e lajmërimit publik të kryer më datë 26-09-2023; shkresën nr.2936 Prot., datë 22.09.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Prefektit të Qarkut Fier, i cili ka konfirmuar kryerjen e lajmërimit publik të kryer më datë 26-09-2023. Gjithashtu, akti administrativ i është njoftuar subjektit edhe me anë të korespondencës elektronike.

Personi juridik debitor “RAFAEL SHOES” sh.p.k me NIPT L93102401C, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 65, me Nr.2584/1 Prot., datë 24/08/2023, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3261 Prot.

Vlorë, më 19/10/2023

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori, subjekti “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.66, me Nr.2585/1 Prot., datë 24/08/2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 25.060 (Njëzet e pesëmijë e gjashtëdhjetë) lekë, në zbatim të nenit 250/4 të Kodit Doganor, si dhe penalitetin në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, në zbatim të nenit 257/1/b të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, ndaj subjektit debitor “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, me seli në Tiranë (Rruga e Durrërsit, Kthesa e Kamzës).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, me anë të Shërbimit Postar me shkresën Nr.2585/2 Prot., datë 28/08/2023, me lëndë Njoftim - Vendimi. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresat si vijon : Shkresën nr.2934 Prot., datë 22.09.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Bashkisë Tiranë, e cila ka konfirmuar kryerjen e lajmërimit publik; shkresën nr.2935 Prot., datë 22.09.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Prefektit të Qarkut Tiranë, i cili ka konfirmuar kryerjen e lajmërimit publik të kryer më datë 26-09-2023. Gjithashtu, akti administrativ i është njoftuar subjektit edhe me anë të korespondencës elektronike.

Personi juridik debitor “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 66, me Nr.2585/1 Prot., datë 24/08/2023, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.66, me Nr.2585/1 Prot., datë 24/08/2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, personave të tretë, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personit juridik - “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NIPT L31311002E, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale **75.060** (Shtatëdhjet e pesëmijë e gjashtëdhjetë) lekë, sipas Vendimit Nr.66, me Nr.2585/1 Prot., datë 24/08/2023, të Degës së Doganës Vlorë.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3263 Prot.

Vlorë, më 19/10/2023

VENDIM

“Për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor që debitori, subjekti “AFERDITA“ sh.p.k, me NIPT J86826208G, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.58, me Nr.1852/2 Prot., datë 11.08.2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 60,293 (gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjet e tre) lekë, për deklaratën doganore IMP. 4 me numër R 2014, datë 20/02/2021, ndaj subjektit debitor “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, me seli në Vlorë (pranë shkollës industriale), me përfaqësues ligjor z.Sihat Zotaj.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G me anë të shërbimit postar me shkresën Nr.1852/3 Prot., datë 16/08/2023.

Me shkresën Nr.1852/4 Prot., datë 25/08/2023, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, me shkresën Nr.2925 Prot., datë 21/09/2023, me lëndë “Kërkesë e përsëritur për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, si dhe me email-in e datës 09-10-2023 me lëndë “Kërkesë e përsëritur për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, Dega e Doganës Vlorë i ka kërkuar subjektit likuidimin në mënyrë vullnetare të detyrimeve doganore.

Subjekti debitor “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 58, me Nr.1852/2 Prot., datë 11.08.2023, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.58, me Nr.1852/2 Prot., datë 11.08.2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë

03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, subjektit - “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, subjektit - “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, subjekti - “AFERDITA” sh.p.k, me NIPT J86826208G, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 60,293 (gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr. 58, me Nr.1852/2 Prot., datë 11.08.2023, të Degës së Doganës Vlorë, si dhe kamatë vonesën e lindur.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1874/1 Prot.

Vlorë, më 12/10/2023

V E N D I M N r . 9 0

Sot, më datë 12/10/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “**CONSULTING PRODUCTION**” sh.p.k me NIPT L66329201T, me seli në Vlorë (Novoselë, rruga nacionale Vlorë – Fier, fshati Novoselë, zona kadastrale nr.1012, nr.pasurie 118/29; Nr. Telefoni të publikuar në Q.K.B 0697714994), me administrator z.Elvis Çeçi, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0007857, nr.1874/1 Prot., datë 18/09/2023, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.441/10 Prot., datë 19/07/2023, protokolluar me Tonën me nr.144/10, datë 20/07/2023, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Doganën Vlorë*”.

Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.144/11 Prot., datë 04/08/2023, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Rezulton se Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, ka proceduar me shkresën Nr.1874 Prot., datë 27/06/2023 me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën ka njoftuar subjektin për fillimin e procedurës administrative. Nga ana e subjektit nuk është administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/shpjegim/prova etj. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me shkresën Nr.1874/1 Prot., datë 18/09/2023 me lëndë “Njoftim i proces verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative”, me të cilën ka njoftuar mbi proces verbalin e shkeljes doganore të mbajtur nga grupi i kontrollit. Proces verbali i është njoftuar subjektit edhe me anë të lajmërimeve publike. Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer, rezulton se subjekti “**CONSULTING PRODUCTION**” sh.p.k me NIPT L66329201T, me seli në Vlorë, ka përfutur nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv

nr. 26872/1 prot., datë 08.11.2019. Nga verifikimet e kryera nga ana e autoriteteve doganore, nga sistemi data base kombëtar, rezulton se në fund të periudhës të regjimit të përpunimit aktiv, bilanci material sipas sistemit asycuda/data base kombëtar, paraqitet si vijon : Tabela. Nr. 1

Nr	Emertimi	Procedura	P. Neto	Tar Pri	Tax. Dog
a	Import 5	5100	82648.5	52936.7	0
b	Export 3	3151	83269.45	52936.8	0
c	Diferencat (a-b)		-621	0	0

Referuar tabelës së mësipërme – konstatohet se autorizimi nuk rezulton i mbyllur për sasinë peshë, - 621 kg. Në shqyrtim të deklaratave të eksportit nuk konstatohet që operatori të ketë trupëzuar në produktin kompensues mallra të blera brenda vendit të cilët në trupëzim në produktin kompensues do rritnin peshën në riekспорт që do të justifikonte edhe diferencën negative në peshë.

- Për këtë diferencë grupi i auditimit në pa mundësi për të përcaktuar llojin dhe vlerën e mallrave, ka bërë përllogaritjet e detyrimeve doganore duke marrë çmimin mesatar të lëndëve të para të importuara në këtë autorizim.

Nr.	Emertimi	Proc.	P. Net	Vlera	Çmimi mesatar Euro/kg
a	Imp. 5	5100	82,649	52,937	0.64

Çmimi mesatar për një kg është 0.64 Euro/kg.

- Për diferencën në sasinë 621 kg në mbështetje në nenet 250 “Klasifikimi i shkeljeve” 1. Shkelje doganore janë: - a) kundërvajtjet administrative; të Ligjit Nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë”, Nenit 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë” pika c, në bazë të nenit 257 pika 1/a dhe pika 2 të Ligjit Nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë”, operatori “Consulting Production” sh.p.k duhet të paguajë penaltetin në masën e dyfishit të detyrimit.

Përllogaritja e detyrimeve:

Sasia 621 kg * 0.64 Euro/kg * 113.21 Kursi = 44,994 lekë

Detyrimi = 44,994 lekë * 20% = 8,999 lekë

Penalitet = 8,999 * 2 fishi = 17,998 lekë

Totali = 26,997 lekë

Detyrimi Doganor	Penalitet	Totali
8,999 lekë	17,998 lekë 2-fish Neni 257 pika 1/a pika. 2	26,997 lekë

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” (i ndryshuar),

V E N D O S A :

- Subjekti “CONSULTING PRODUCTION” sh.p.k me NIPT L66329201T, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **8,999** (Tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjet e nëntë) lekë.
- Subjekti “CONSULTING PRODUCTION” sh.p.k me NIPT L66329201T të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **17,998** (Shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjet e tetë) lekë, bazuar në nenin 2576/1/a të Kodit Doganor.
- Për të proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ngarkohen Sektori i Mbikqyrjes Doganore, Zyra e Financës dhe Zyra e Borxhit Doganor.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “CONSULTING PRODUCTION” sh.p.k me NIPT L66329201T, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), si dhe duke garantuar 100% penaltetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2976/1 Prot.

Vlorë, më 13/10/2023

VENDIM Nr.91

Sot, më datë 13/10/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “TOMAIFICIO “MARO” sh.p.k me NIPT L36401201R, me seli në Vlorë (Lagjia “Kushtrimi”, pranë ish përpunim druri, objekt një katësh, Nr.39/102), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0007860, nr.2976 Prot., datë 26/09/2023, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

KONSTATOVA SE :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.441/10 Prot., datë 19/07/2023, protokolluar me Tonën me nr.144/10, datë 20/07/2023, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Doganën Vlorë*”.

Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.144/11 Prot., datë 04/08/2023, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer, rezulton se subjekti “TOMAIFICIO “MARO” sh.p.k me NIPT L36401201R, me seli në Vlorë, ka përfituar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv nr.22997/1 prot., datë 02.04.2021, për prodhimin e faqe për veshje këmbësh dhe veshje këmbësh të përfunduara dhe te papërfunduara, lëkurë dhe metrazhe me difekt jo konforme etj. Nga verifikimet e kryera nga ana e autoriteteve doganore, ka rezultuar se në fund të periudhës të regjimit të përpunimit aktiv, në fund të periudhës të regjimit të përpunimit aktiv, bilanci material sipas sistemit asycuda / data base kombëtar, paraqitet si vijon : *Tabela. Nr. 1*

Nr	Emertimi	Procedura	P. Neto	Tar Pri	Tax. Dog
a	Import 5	5100	149,249	2,629,562	418,325
b	Export 3	3151	107,967	2,423,010	403,175
c	Import 9	9351	29,658	0	0
d	Transf. nw Aut. 9493/1, dt.,01.04.2022 Shoq. "Victor" DAV-I me nr. R7106 dt., 24.05.2022		10,790	209,879	12,783
e	Diferencat (a-b-c-d)		833	-3,327	2,367

Referuar tabelës së mësipërme – konstatohet se autorizimi nuk rezulton i mbyllur për peshë 833 kg, vlerë negative 3,327 Euro. Në shqyrtim të dokumentit të mbylljes, shkresa me nr.3405/1 prot., datë 21.10.2022 konstatohet se ka mospërputhje midis të dhënave të paraqitura në këtë dokument (Aneksi 8), me të dhënat e data base kombëtare, konkretisht për sasinë kg dhe vlerë për produktin kompensues të rieksportuar. Në dokumentin e mbylljes së regjimit, operatori ekonomik paraqet sikur ka rieksportuar sasinë 108,800 kg (ndërkohë sipas të dhënave të sistemit Asycuda World/data base kombëtar është 107,967 kg duke dhënë një diferencë në 833.09 kg) dhe vlera 2,419,683.36 Euro (sipas të dhënave të sistemit Asycuda World/Data base kombëtare është 2,423,010 Euro – duke dhënë diferencë për 3326.64 Euro). Për diferencën në peshë prej 833 kg grupi i auditimit - për qëllime doganore e konsideron si lëndë të parë e pa rieksportuar dhe ka bërë përlllogaritjet e detyrimeve doganore duke marrë çmimin mesatar të materialeve të importuara në këtë autorizim.

Nr.	Emërtimi	Proc.	P. Net	Vlera	Çmimi mesatar Euro/kg
a	Imp. 5	5100	149,249	2,629,562	
b	Transf. në Aut. 9493/1 dt., 01.04.2022 shoq. Victor	5151	10,790	209,879	
c	Mallra të përdorura (a-b)		138,459	2,419,683	17.475

Çmimi mesatar për një kg është 17.48 Euro/kg.

Detyrimi Doganor	Penalitet	Totali
329,607 lekë	659,214 lekë 2-fish Neni 257 pika 1/a pika 2	988,821 lekë

- Për diferencën në sasinë 833 kg në mbështetje në nenet 250 “Klasifikimi i shkeljeve” 1. Shkelje doganore janë: - a) kundërvajtjet administrative; të Ligjit Nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë”, Nenit 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë” pika c, në bazë të nenit 257 pika 1/a dhe pika 2 të Ligjit Nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë” rekomandon që operatori ‘Tomaficio Maro’ shpk të paguaj penalitet dyfishin e detyrimit.

Përlllogaritja e detyrimeve:

Sasia 833 kg * 17.48 Euro/kg * 113.21 Kursi = 1,648,037 lekë

Detyrimi = 1,648,037 lekë * 20% = 329,607 lekë

Penalitet = 329,607 * 2 fishi = 659,214 lekë

Totali = 988,821 lekë

Rezulton se Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, ka

proceduar me shkresën Nr.1873 Prot., datë 27/06/2023 me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën ka njoftuar subjektin për fillimin e procedurës administrative.

Më tej, nga ana e grupit të punës në përfundim të verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, është mbajtur procesverbal i shkeljes doganore “kundërvajtje administrative” nr.serial 0007860, nr.2976 Prot., datë 26/09/2023, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes doganore të kryer nga ana e subjektit si vijon : *“Referuar raportit përfundimtar të auditit Nr.441/10 dt 19.07.2023, operatori ekonomik “Tomaificio Maro” i pajisur me autorizimin RPA Nr.22997/1 prot dt. 02.04.2021, rezulton se nuk e ka mbyllur autorizimin RPA, duke rezultuar me një diferencë negative në vlerë 3327 euro dhe 833 kg në peshë. Për diferencën prej 833 kg e cila konsiderohet si lëndë e parë e parieksportuar u bënë llogaritjet duke marrë çmimin mesatar të materialeve të importuara në këtë autorizim”.*

Ky proces verbal i është njoftuar subjektit me anë të shërbimit postar me shkresën nr.2976/1 Prot., datë 27/09/2023, me lëndë “Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, si dhe me anë të njoftimit publik, konkretisht, me shkresën nr.2979 Prot., datë 27/09/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të proces verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative” drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili, ka konfirmuar njoftimin publik me shkresën Nr.884/1 Prot., datë 06/10/2023, me lëndë “Mbi shpalljen publike ...”, administruar në sekretarinë e degës së doganës Vlorë me nr.2979/1 Prot., datë 09/10/2023; shkresën nr.2980 Prot., datë 27/09/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të proces verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative” drejtuar Bashkisë Vlorë, si dhe me anë të korespondencës elektronike.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” (i ndryshuar),

V E N D O S A :

- Subjekti “TOMAIFICIO “MARO” sh.p.k me NIPT L36401201R, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **329,607** (Treqind e njëzet e nëntëmijë e gjashtëqind e shtatë) lekë.

- Subjekti “TOMAIFICIO “MARO” sh.p.k me NIPT L36401201R të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **659,214** (Gjashtëqind e pesëdhjet e nëntëmijë e dyqind e katërmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “TOMAIFICIO “MARO” sh.p.k me NIPT L36401201R, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), si dhe duke garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR
Artan Bedinaj

